



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Komuna e Drenasit



Shkresë	26.01.2026
Nga:	ZPP Gentiana Qela
PER:	PRO MEDICAL SH.P.K
Lenda :	VENDIM

Në pajtim me nenin 108/A, paragrafi 10, nën paragrafi 10.2 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068 si dhe Ligjin 04/L-237 si dhe Ligjin nr. 05/L-092 si dhe Rregullores (A01) nr.001/dhe 002/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “ PRO MEDICAL SH.P.K të datës 20.01.2026 kundër njoftimit per kontrate për procedure të prokurimit me numër 611-25-2667-1-2-1 me titull “ Paisje stomatologjike per nevoja te QKMF” dates 02.04.2025, Komuna e Drenasit (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit sjell:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik PRO MEDICAL SH.P.K “të datës 20.01.2026 kundër njoftimit per dhenje të aktivitetit të prokurimit me numër 611-25-2667-1-2-1 me titull “Paisje stomatologjike per nevoja te QKMF” datës 02.04.2025
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdojë me njoftimin per dhenje të projektit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik “PRO MEDICAL SH.P.K si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike e-prokurimi në adresën <http://e-prokurimi.rks-gov.net>
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Autoriteti Kontraktues ka analizuar pretendimet e juaja ankimore dhe ka vlersuar se pretendimet e paraqitura jane te pabazuar .

Ju jeni operator ekonomik i papergjegjshem ne lidhje me kete procedure pasi qe Autoriteti Kontraktues ka kerkuar sqarime dy here rradhazi ne lidhje me kontaktet per kompanit autorizuese te cilat ju keni prezentuar ne dosje . pasi qe ju nuk i keni prezentuar te dhenat e kerkuara , autoriteti ka bere verifikimin ne adresen e

veteme e cila figuron ne dosje . Sipas sqarimeve te dhena del qe ju keni bere mashtrim ne prokurim publik duke nderhyre ne autorizimin e leshuar nga kompania kineze dhe e cila ka veretetur qe autorizimi eshte leshuar ne vitin 2023 dhe jo ne vitin 2024 siq keni prezentuar ne dosje. Rrjedhimisht ju keni bere mashtrim ne Prokurim Publik dhe autoriteti ka bere kerkesen per liste te zeze sipas procedurave ligjore .

Sa i perkete operatorit te rekomanduar per kontrate jane plotesuar te gjitha specifikat teknike dhe preofesionale sipas dosjes se tenderit . Komisioni(te cilet jane profesionit te fushes se stomatologjis) konstaton qe operatori ekonomik i rekomanduar per kontrate ka permbushur kereksat e paramases sipas katalogeve te prezentuara .

Kunder ketij vendimi keni te drejt ankese ne OSHP ne afatë prej 10 ditë !

Me respekt !